



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

969/20  
16.12.2020

PRISHTINE - PRISTINA

PSH.nr.969/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi -Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Baki-Ing SH.P.K” Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.T.SH. “MONT ELEKTRO”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo” LOT 1. me nr. prok. KEK-20-4256-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/-“Korporata Energjetike e Kosovës”sh.a, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Baki-Ing SH.P.K” Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo” LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/-“Korporata Energjetike e Kosovës”sh.a.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo” LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/-“Korporata Energjetike e Kosovës ”sh.a. dhe lënda kthehet ne **Rivleresim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "Baki-Ing SH.P.K" Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Baki-Ing SH.P.K" Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.11.2020 me nr. 969/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo" LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues/AK/-"Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 28, 56, 59, 60, 69, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. si dhe nenin 41 dhe 20 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 01.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka bere shkele te nenit 1, 6, 7, 28, 56, 59, 60, 69 dhe 108/A te LPP-se sepse ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit te dhënë ne specifikimin teknik për fuqinë e elektromotorit që është kërkuar 44 KË, kurse është ofruar prej 40 kë. Ky elektromotor nuk e ka fuqinë e nevojshme për hapje dhe mbyllje te ndërprerësit dhe nisur nga ky fakt del qe edhe ndërprerësi nuk do te jete funksional, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ka rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofruar elektromotorin me fuçi 40 kë qe është për 4 kë me i vogël se elektromotori i dhënë ne specifikim teknik i cili qe ka gene me fuçi 44 kë. Te dy elektromotorët janë te njëjtit tip Pg 6325-30/44-RL.

Elektromotori i ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate me parametrat përkatës është ne vijim.

Type: Pg 6325-30/44-RL

- Voltage 110 V DC
- Current 0,60 A
- Number of rotations 3000 rpm
- Poëer 40 Ë



Ndërsa ne figurën e më poshtme është elektromotori i kërkuar me specifikim të dosjes së tenderit elektromotor rezervë (tipi: Pg 6325-30/44-RL ose ekuivalent) për përgatitjen për operim të ndërprerësit

- Tensioni 110 V DC
- Fuqia 44 Ë
- Rryma 0,60 A
- Numri i rrotullimeve 3000 rpm



Ndryshimi i vetëm është të fuqia e elektromotorit. Te gjithë parametrat e tjerë janë të njëjtë. Psh te dy elektromotorët kanë numër të njëjtin të rrotullimeve prej 3000 rrot/min. Autoriteti kontraktues respektivisht komisioni vlerësues këtë ndryshim të fuqisë së elektromotorit prej 4 kë e ka vlerësuar si të pa ndikim në funksionalitetin e elektromotorit dhe si tolerance e lejuar teknike. Meqenëse autoriteti kontraktues ka personel të mjaftueshëm me kualifikime dhe njohuri adekuate në këtë fushë të cilët kanë edhe përvojën përkatëse në funksionimin e këtyre pajisjeve dhe kanë ardhur në një përfundim të tillë, andaj edhe eksperti shqyrtues ndanë mendim të njëjtë.

Devijime te vogla te cilat nuk ndikojnë ne funksionalitet, nuk janë te larguara substancialisht dhe esencialisht nga ato te kërkuara, janë te lejuara dhe me dispozitat e nenit 59 te LPP-se dhe nenin 41 te RRUOPP . Pra pretendimi se janë shkele nenet e LPP-se te cilët janë paraqitur ne ankese nga OE ankues nuk qëndrojnë. Mbi këtë baze ekspertit shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, rivlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me dispozitat e nenit 59 të LPP-së ka rekomanduar për kontratë oferta e përgjegjshme me çmim më të ultë.

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë është mbi 6800 € më e lirë se oferta e OE ankues. Pra nga AK është respektuar edhe neni 60 i LPP-së. Nuk ka shkelje të dispozitave të LPP-së të cilat përmenden në ankesë e operatorit ekonomik të cilat do ta dëmtonin procesin e prokurimit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo” LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 012.12.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 28, 56, 59, 60, 69 dhe 108/A të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit të dhënë në specifikimin teknik për fuqinë e elektromotorit që është kërkuar 44 KW, kurse është ofruar prej 40 kw. Ky elektromotor nuk e ka fuqinë e nevojshme për hapje dhe mbyllje te ndërprerësit dhe nisur nga ky fakt del që edhe ndërprerësi nuk do të jetë funksional.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ka

rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofruar elektromotorin me fuçi 40 kw që është për 4 kw me i vogël se elektromotori i dhënë në specifikim teknik i cili që ka qenë me fuçi 44 kw, dhe ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që nuk është ofruar pajisja siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KEK"sh.a;
- 1x1 OE "Baki-Ing SH.P.K"-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

